



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**

**Data 05.04.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Pajisje elektronike dhe kompjuterike” i ndarë sipas loteve:**

**Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)**

**Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres (paisje kompjuterike)**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Fotokopjuese 30121100-4

Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1

Kompjuter desktop 30213300-8

Printer laser 30232110-8

Kompjuter portativ 30213100-6

Pajisje elektronike 31710000-6

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 10.113.400 (dhjetë milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind)lek,  
pa tvsh, i ndarë sipas loteve:

Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj): 10.040.000 (dhjetë milion e dyzet mijë)lekë,pa tvsh.

Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres (paisje kompjuterike): 73.400 (shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind)lekë,pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”,autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99% e vlerës të fondit të limit të lotit që prokurohet .

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 99% e vlerës të fondit të limit të kësaj kontrate,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatimin mbi të ardhurat", indryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formëselektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".**

## **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit lotit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi*

të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

---

## 2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** : *Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Kerkesa per çertifikaten e mesiperme eshte konsideruar e nevojshme,duke patur parasysh natyren dhe vleren e objektit te prokurimit, per vertetuar se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi permbushin standartin e cilesise per te cilen leshohet kjo çertifikate me qellim qe autoriteti kontraktor te vertetoje permbushjen e kontrates ne perputhje me standartet e cilesise.*

---

**2.3.2** Për të vertetuar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet të paraqese katalogun teknik ose skedat teknike për produktet e mëposhtme:

1	Printer all in one(black and white)
2	FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A3
3	Printer all in one Color
4	Kompjuter desktop
5	Kompjuter workstation
6	Kompjuter workstation tipi 2
7	Kompjuter all in one
8	Laptop Advanced
9	Laptop Basic
10	Switch me 8 porta menaxhueshem
15	HDD 1 TB SATA
22	Projektor
25	Server
26	Karte rrjeti profesionale 1Gb me 4 porta

**Në katalog apo skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të kërkuara në specifikimet teknike të publikuara me dokumentat e tenderit.**

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, gërma b të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë autoritetit kontraktor që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.*

---

## **Loti 2- Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres (paisje kompjuterike)**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99% fondit të limit të lotit që prokurohet.

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shumat e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

---

*Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogël se 99% e vlerës të fondit të limit të kësaj kontrate,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne ,neni 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjitnr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatimin mbi të ardhurat", indryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formëselektronike", si dhe kërkesave të LigjitNr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.**

---

## **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit lotit që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

## **2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur Çertifikaten ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** *Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Kerkesa per çertifikaten e mesiperme eshte konsideruar e nevojshme,duke patur parasysht natyren dhe vleren e objektit te prokurimit, per vertetuar se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi permbushin standartin e cilesise per te cilen leshohet kjo çertifikate me qellim qe autoriteti kontraktor te vertetoje permbushjen e kontrates ne perputhje me standartet e cilesise.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke*

*argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr 113 date 15.02.2024**

**Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**